



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:250128
Datë: 20.02.2024
Numri i dokumentit: 05346434

KPPP.nr.1260/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Banka Ekonomike Sh.A. me nr. të biznesit 70177683 me seli në Prishtinë, kundër debitorëve 1. D.P.H. “Pit Cafe” me nr. të biznesit 70666006 dhe me seli në Prishtinë, lagja “Bregu i Diellit-Qendra Tregtare”, me pronar Gazmend Mikullovc, 2. E.M. me adresë në Mitrovicë, rr. “M. Teuta” dhe 3. B.M., me adresë në Mitrovicë, rr. “Sheshi i Jasharëve” p.nr, në çështjen përmbartimore sipas urdhrit P.nr. 1743/17 të datës 12.10.2017, të lejuar nga Përmbartues Privat Flamur S. Bogaj, duke vepruar sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin AC.nr. 6265/2020 të datës 27.09.2021, jashtë seancës, me datë 20.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorëve 1. D.P.H. “Pit Cafe”, 2. E.M. dhe 3. B.M., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 1743/17 i datës 12.10.2017, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Banka Ekonomike Sh.A. ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr. 1743/17 i datës 12.10.2017, me të cilin ka lejuar përmbartimin ndaj debitorëve 1. D.P.H. “Pit Cafe”, 2. E.M. dhe 3. B.M., në bazë të Marrëveshjes mbi pengun nr. 536/5/MI e datës 23.06.2010 e regjistruar sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut R-20131125-159, me qëllim të realizimit të borxhit të papaguar të kredisë sipas marrëveshjes kreditore për kredi për individ nr. 536/5/MI e datës 23.06.2010, nga debitori në vlerë prej

5,080.53 EUR, së bashku me normën e rregullt dhe kamatëvonesën ligjore si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore aq sa do të jenë sipas organit përbarues.

Debitorët 1. D.P.H. “Pit Cafe”, 2. E.M. dhe 3. B.M., brenda afatit ligjor kanë paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përbarimit me arsyetimin se dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi nuk janë paraqitur në origjinal, ashtu siç kërkohet me nenin 38 të LPP-së e po ashtu kanë shtuar se biznesi për të cilin është marrë kredia veçse ka falimentuar, e rrjedhimisht malli i përfshirë sipas listës së pengut është asgjësuar. Tutje kanë theksuar se në marrëveshjen mbi pengun në momentin e lëshimit të kredisë nuk kanë qenë të përfshira edhe llogaritë bankare të debitorëve, e po ashtu nuk kanë qenë të përfshirë as ndonjë paluajtshmëri për këtë kredi, por vetëm malli i listuar në marrëveshjen e pengut. Me kërkesë që të pranohet prapësimi ndërsa Urdhri Përbarimor të anulohet.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit me arsyetimin se debitorët nuk kanë ofruar asnjë provë për të mbështetur deklaratimet e tyre, andaj edhe qëllimi i vetëm është prolongimi i çështjes. Gjykatës i kanë kërkuar që prapësimi i debitorëve të refuzohet ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr. 1049/2017 të datës 13.11.2018 ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorëve dhe ka anuluar urdhrin përbarimor P.nr. 1743/2017 të datës 12.10.2017 me arsyetimin se dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi nuk janë paraqitur në origjinal apo në kopje të vërtetuar nga origjinali.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin Ac.nr. 6265/2020 të datës 27.09.2021 ka pranuar si të bazuar ankesën e kreditorit dhe ka prishur aktvendimin PPP.nr. 1049/2017 të datës 13.11.2018, ashtu që lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë shkallës së parë.

Gjykata, në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsytet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të*

besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”, ndërsa sipas nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se dokument përmbartues paraqet: “...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”. Ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se “Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit”.

Gjykata ka vlerësuar marrëveshjen mbi pengun nr. 536/5/MI e datës 23.06.2010 dhe konfirmimin e regjistrimit të pengut me nr. R-20131125-159, dhe gjeti se debitori i parë D.P.H “PTIT CAFE” nuk rezulton të jetë i listuar si penglënës me llogaritë e tij bankare dhe as me paluajtshmëritë që evidentohen në emër të tij, përkatësisht llogaritë bankare dhe paluajtshmëritë eventuale të tij nuk janë pjesë e Marrëveshjes mbi pengun dhe nuk janë të regjistruara si peng pranë regjistrin zyrtar të pengut. Në anën tjetër, debitorët E.M. dhe B.M. nuk evidentohen fare si penglënës në Konfirmimin mbi regjistrimin e pengut.

Përkundër kësaj, urdhri për lejimin e përmbartimit ka paraparë bllokimin e llogarive bankare të të gjithë debitorëve apo në alternativë shitjen e pasurisë së paluajtshme të tyre me qëllim të realizimit të borxhit që derivon nga marrëveshja kreditore për kredi për individ nr. 536/5/MI e datës 23.06.2010.

Si rezultat i kësaj, gjykata gjen se prapësimi i debitorëve gjen mbështetje në nenin 71, paragrafi 1, pika 1.6, ngase kreditori nuk është i autorizuar që të kërkoj përmbartjen nga debitorët E.M. dhe B.M. meqenëse të njëjtit nuk identifikohen si debitor në konfirmimin mbi regjistrimin e pengut, e në anën tjetër, kreditori nuk është i autorizuar që të kërkoj bllokimin e llogarive bankare apo eventualisht shitjen e pasurisë së paluajtshme në emër të D.P.H. “Pit Cafe”, për faktin se në konfirmimin mbi regjistrimin e pengut me numër R-20131125-159 ky i fundit nuk garantuar kthimin e borxhit nga marrëveshja kreditore në formën e kërkuar sipas propozimit për përmbartim.

Andaj, meqenëse propozimi për përmbartim e rrjedhimisht edhe urdhri për lejimin e përmbartimit nuk janë në përputhje me dokumentin mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi për shkak të tejkalimit të kufijve të përmbartimit të përcaktuar në këtë dokument, duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1260/22 dt. 20.02.2024

Gj y q t a r i

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.